

Fondi i Kursimeve Pensionale i Kosovës (FKPK) është institucion i pavarur, i themeluar për të administruar sistemin e kursimeve të obligueshme pensionale në Kosovë, dhe vepron në kuadër të Ligjit Nr. 04/L-101 për fondet pensionale në Kosovë dhe me plotësimet e mëtutjeshme të këtij ligji. FKPK-ja, në përputhje me Ligjin e Punës Nr. 03/L-212 e shpall këtë:

KONKURS PUBLIK

për angazhimin me kontratë për punë dhe detyra specifike sikur në vijim:

Titulli i pozitës:	PRODUCENT I MULTI-MEDIAS
Orët e punës:	Jo më shumë se 120 ditë në vit (kryesisht punë në distancë)
Numri i referencës:	KON112024
Kohëzgjatja e emërimit:	Kontratë për punë dhe detyra specifike
Adresa:	Rr. "Agim Ramadani" Nr. 182-184, 10000 Prishtinë

Detyrat dhe përgjegjësitë e producentit:

- Të ndihmojë në projektimin e fushatave vetëdijësuese dhe informuese.
- Të prodhojë video përmbajtje multi-mediale sipas nevojave të FKPK-së.
- Të bashkëpunojë (kur ka nevojë) me palë të treta për të realizuar projekte të prodhimit multi-medial.
- Të jetë i përpiktë në realizimin e kërkesave nga FKPK-ja.

Kriteret e konkursit:

- Arsimimi:**
- Të jetë diplomuar ose në proces të përfundimit të arsimit të lartë universitar në fushën e regjisë ose arteve.
 - Të ketë së paku tri vjet përvojë në prodhimin e reklamave dhe produkteve të tjera të ngjashme multimediale (të dëshmuara).
 - Të ketë qenë producent në së paku pesë prodhime të video-reklamave (të dëshmuara).

Përvoja: Producenti i multi-medias duhet të ketë përvojë të dëshmuar në: a) xhirim, b) montazh, c) animacione grafike (2D dhe 3D), d) aftësi të menaxhimit të projekteve, e) udhëheqje e procesit të prodhimit (nga fillimi deri në finalizim) dhe f) kapacitete të larta organizative me palët e nevojshme për produktet multimediale.

Dëshmi: Të dërgohen dëshmi për arsimimin dhe kërkesat e përvojës së punës!

Afati dhe mënyra e konkurrimit:

- Konkursi është i hapur **prej 5 nëntorit 2024 e deri më 20 nëntor 2024 në ora 23:59 (CET)**.
- Aplikimi bëhet vetëm përmes email-it në adresën: **recruitment@trusti.org**, me referencë: **"Producent i multi-medias"**.
- Email-it duhet t'i bashkëlidhen edhe dokumentet në vijim: 1) Biografia (CV); 2) Letërmotivimi, 3) Dëshmitë e shkollimit dhe 4) Dëshmitë e përvojës së punës - të gjitha në formatin pdf.

Vërejtje: Aplikacionet pa dokumentet e lartcekura të bashkangjitura, ose që nuk janë në formatin e kërkuar, NUK do të shqyrtohen. Vetëm kandidatët që i plotësojnë kushtet do të kontaktohen.

FKPK-ja është punëdhënës që ofron mundësi të barabarta për të gjithë!